

Ndryshimet në mënyrën se si udhëtoni

Për t'u përgatitur për më shumë trena, të cilët do të jenë edhe më të shpeshtë pas hapjes së tunelit të metrosë më vonë këtë vit, do ta mbyllim rrugën Webster te kalimi në nivel në tetor dhe do të ndërtojmë një rrugë të re nën linjën hekurudhore, e cila do të hapet në vitin 2026.

Nënkalimi i ri do të lidhë rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Nënkalimi rrugor i ri do të përmirësojë sigurinë, duke zvogëluar mbingarkesën dhe duke krijuar një rrjet rrugor më të besueshëm në Dandenong, në mënyrë që të ridrejtohet trafiku larg qendrës dhe të mbahen automjetet e rënda larg rrugës Webster.

Në këtë mënyrë, Dandenong do të përgatitet për zhvillim në të ardhmen.

Një shteg i ri për ecje dhe çiklizëm nën urën hekurudhore Dandenong Creek do të hapet nga ora **07:00, të premten, më 10 tetor**. Ai do të lidhet me shtegun ekzistues Dandenong Creek, duke siguruar qasje më të sigurt për këmbësorët dhe çiklistët nën linjën hekurudhore.

Mbyllja e kalimit në nivel në tetor do ta përgatisë komunitetin për hapjen e tunelit të metrosë më vonë këtë vit. Ky tunel do të mundësojë qarkullimin më të shpeshtë të më shumë trenave nëpër Dandenong në linjat Cranbourne dhe Pakenham, të cilat do të jenë plotësisht pa barriera.

Rruga Webster do të mbyllet te kalimi në nivel nga ora 21:00, të premten më 10 tetor, ndërsa nënkalimi rrugor i ri do të hapet në vitin 2026, dy vjet para afatit.

Pse duhet të hiqet ky kalim në nivel?




Deri në **10.000 automjete** udhëtojnë nëpër këtë kalim çdo ditë



Barrierat janë të mbyllura për **më shumë se një orë** vetëm gjatë pikut të trafikut në mëngjes (nga ora 07:00 deri në orën 09:00)



22 aksidente të afërta që nga viti 2012



Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel dhe tek udhëkryqi me nënkalimin e ri te rruga Princes Highway-Lonsdale. Përshtypja e artistit, mund të ndryshojë.

Qarkullimi nëpër Dandenong

Me rrugën Webster të mbyllur te kalimi në nivel nga ora 21:00, të premten më 10 tetor, do të ketë ndryshime në mënyrën se si udhëtoni gjatë kohës që ndërtojmë nënkalimin rrugor të ri.

Për automjetet që udhëtojnë në rrugën Webster, rruga e devijimit do të jetë nëpër Hammond Road, Dandenong Bypass, Frankston-Dandenong Road, Princes Highway-Lonsdale Street, Foster Street dhe Cheltenham Road.

Rruga alternative e devijimit do të jetë nëpër Hammond Road, Cheltenham Road, George Street, Walker Street dhe Princes Highway-Lonsdale Street.

Automjetet mbi 3,8 metra duhet të marrin rrugën për automjete të larta nëpër Hammond Road, Dandenong Bypass, Frankston-Dandenong Road dhe Prince Highway-Lonsdale Street.

Në këtë mënyrë, do të shmangët ura me lartësi të kufizuar në rrugën Cheltenham.

Herë pas here, këto rrugë mund të ndryshohen përkohësisht për shkak të mbylljeve të rrugëve ose korsive gjatë ndërtimit të nënkalimit rrugor të ri.

Do të ulen gjithashtu kufizimet e shpejtësisë – kushtojuni vëmendje tabelave dhe respektoni shpejtësitë më të ulëta për të mbajtur rrugët tona të sigurta.

Nënkalimi rrugor i ri do të ketë një lartësi prej 5,8 metrash, duke e bërë atë të sigurt dhe të arritshëm për automjetet e larta.

Për të mësuar se si do të qarkullojnë automjetet e rënda dhe të mëdha nëpër Dandenong, pasi të mbyllet rruga Webster te kalimi në nivel, vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-travel-changes

Faleminderit për durimin tuaj ndërsa e heqim kalimin në nivel në Dandenong.



Kthimi i sigurt në Dandenong Bypass

Këto rrugë devijimi janë planifikuar me kujdes për të përdorur rrugë kryesore dhe udhëkryqe me semaforë, duke dhënë prioritet sigurisë, kohës së udhëtimit dhe minimizimit të ngarkesës së trafikut.

Udhëkryqi i Dandenong Bypass-it me Hammond Road ka semaforë që do t'ju ndihmojnë të ktheheni majtas dhe djathtas në mënyrë të sigurt.

Për sigurinë e këmbësorëve dhe përdoruesve të tjerë të rrugës, shmangni përdorimin e rrugëve banesore kur është e mundur gjatë udhëtimit nëpër këtë zonë.



Mësoni më shumë për ndryshimet në mënyrën se si udhëtoni

Skanozi kodin QR ose vizitoni: levelcrossings.vic.gov.au/webster-travel-changes

Përcaktimi i rrugëve të udhëtimit

Për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të udhëtuar nëpër Dandenong, kemi punuar me Departamentin e Transportit dhe Planifikimit, Freight Victoria dhe Këshillin e Qytetit Greater Dandenong.

Ne përdorim gjithashtu modelimin e trafikut për të kuptuar performancën e tanishme dhe të parashikuar të rrjetit rrugor dhe për të mbajtur komunitetin në lëvizje.

Modeli i trafikut shërben si bazë për vendimet kryesore lidhur me çdo ndryshim në rrjetin rrugor.

Ky modelim merr në konsideratë:

- rrethrotullimet
- semaforët
- kufizimet më të ulëta të shpejtësisë gjatë kohës së shkollës
- lëvizjet e transportit publik, këmbësorëve dhe çiklistëve.

Nënkalimi rrugor i ri



do të përmirësojë sigurinë, duke zvogëluar mbingarkesën dhe duke krijuar një rrjet rrugor më të besueshëm në Dandenong



do të ridrejtojë trafikun larg qendrës, duke mbajtur automjetet e rënda larg rrugës Webster



do të përgatisë Dandenong për zhvillim në të ardhmen

Qarkullimi nëpër Dandenong





Shtegu juaj i ri për ecje dhe çiklizëm

Shtegu i ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster në Rezervën Woodcock do të jetë e hapur nga ora 07:00, të premten më 10 tetor.

Shtegu i ri do të shtrihet përgjatë anës jugore të përroit Dandenong Creek, nën linjën hekurudhore, duke u lidhur me shtegun Dandenong Creek dhe duke u siguruar banorëve qasje në dyqanet dhe shërbimet lokale në qendrën e Dandenong-ut.

Kemi përmirësuar dizajnin e shtegut të ri duke përfshirë një pjesë të shtruar me dru që po ndërtohet rreth një peme të madhe River Red Gum në Rezervatin Woodcock.



Qëndroni të informuar

Regjistrohuni për përditësime me email duke vizituar levelcrossings.vic.gov.au/subscribe dhe nën seksionin Cranbourne-Pakenham lines, zgjidhni rrugën Webster, Dandenong.



Regjistrohuni për përditësime me SMS lidhur me projektin e heqjes së kalimit në nivel në rrugën Webster

Skanoni kodin QR ose dërgoni tekstin **WEBSTER** në numrin **0428 581 917**

Afatet kohore të projektit



2019

— Projekti u njoftua



2022 deri në fund të vitit 2023

— Hetimet në terren, sondazhet e trafikut dhe punimet e planifikimit



Nëntor 2023

— Dizajnet konceptuale janë lëshuar
— Konsultimi me komunitetin
— Hetimet në terren vazhdojnë



Fundi i vitit 2024

— Dizajnet përfundimtare janë lëshuar
— Punimet e para



2025

— Fillon ndërtimi
— Hapet shtegu i ecjes dhe çiklizmit nën linjën hekurudhore
— Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel
— Barrierat hiqen përgjithmonë



2026

— Ndërtimi
— Nënkalimi rrugor i ri hapet dy vjet më herët
— Sistemimi i hapësirave të jashtme

* Afatet kohore mund të ndryshojnë.



Punimet janë në vazhdim, dyqanet dhe bizneset janë të hapura

Ju falënderojmë që blini lokalisht gjatë ndërtimit.

Tregtarët në rrugët Thomas, Lonsdale dhe Webster janë të hapur për biznes.



levelcrossings.vic.gov.au

contact@levelcrossings.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)     

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni relayservice.gov.au

